



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 453/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit K. Sh, sipas aktakuzës së PPTH në Pejë PP/II nr.190/17 të dt.21.4.2017 për vepre penale : vjedhje e rëndë nga neni 328 par 2 nën p par 1.2 e lidhur me par 1 të KPRK-së, pas mbajtjes se seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur në praninë të pandehurit K. Sh , mbrojtësi zëvendësues av. T. Rr. nga Peja sipas autorizimit, të dëmtuarit A. D , dhe të prokurorit të shtetit Esad Muharemi , me dt.28.4.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri K. Sh i lindur me dt.01.4.1977 në fsh. V.K e G , i biri i M dhe nënës H e gjinisë G , , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 30.12.2017 rreth orës 22-23:30 , në Pejë , në parkingun e objektit banesor në rrugën S. L -T. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete ia merr pasurin e luajtshme tjetrit dhe atë të dëmtuarit A.D nga Peja në mënyrë që shkon në vendin e lartcekur ku dëshmitari H. Z e kishte parkuar dhe mbyllur automjetin MBW X6 , me targa austriake ----- , i pandehuri Kadri Shala e hap automjetin , me qelës të cilin me herët e kishte kopjuar e aktivizon të njëjtin dhe e drejton për në shtetin Gjerman duke kaluar nëpër pikat kufitare Merdare , me ç’rast vërtetohet në incizimet e kamerave kufitare duke kaluar – shkuar për në R të Serbisë , ku të njëjtën ditë kthehet për në Kosovës pa automjetin në fjalë.

-me çka ka kryer vepër penale: vjedhje e rëndë nga neni 327 par 2 nën par 1.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 41,42,43,45,46, 47 dhe nenit 327 par 2 nën par 1.2 lidhur me par 1 të KPRK-së, të pandehurin,

E G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 muajsh , të cilin dënim i pandehuri do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim duke filluar prej 28.1.2017 e deri me datë 28.4.2017 .

Pjesa tjetër e mbetur e dënimit prej 3 muaj me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **1.800 € (njëmijetëqind) euro**, të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj menjëherë, në rast të mospagimit gjoba në fjalë i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro të dënimit me gjobë i shqiptohet një ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 80 euro kurse në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 20 euro – dhe të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të pandehurit me dt. 28.4.2017 në ora 16.00 i ndërpritet paraburgimit dhe i njëjtiti do të mbrohet në liri

I dëmtuari për realizimin eventual të kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 21.4.2017 kundër të pandehurit K. Sh ka ngritë aktakuzë PP/II nr.190/17, për vepre penale : të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par 2 nën par 1.2 e lidhur me par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Bashkë me aktakuzën i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç mënyrë është njoftuar gjykata për detalet dhe është lutur që të mbahet shqyrtimi gjyqësorë sa më shpejtë që është e mundur .

Në shqyrtimin gjyqësorë në të cilin kanë prezantuar i pandehuri K.Sh , mbrojtësi zëvendësues av. T.Rr., i dëmtuari A. D dhe prokurori i shtetit Esad Muharemi është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se : i pandehuri , mbrojtësi i tij , i dëmtuari dhe prokurori i shtetit me dt. 19.4.2017 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe këtë marrëveshje gjyqtari e ka pranuar – i bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtari e konfirmoj edhe vendimin mbi masën ndëshkuese ashtu siç është precizuar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 të KPRK-së

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit është marrë konform nenit 83 par 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi ndërprerjen e paraburgimit është marrë konform nenit 367 par 1 pika 1.2 dhe par 6 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.28.4.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .